



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 16.01.2013
Nr. 0203-42

Naim Baftiu
Sekretarin e Përgjithshëm
Ministria e Financave

Lënda: Shkresë Përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 15.01.2013 ka pranuar, **Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba komunale të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, më qellim të vlerësimit të ligjshmërisë.**

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, ju si ministri Kryesuese e Komisionit, po ju përcjellim për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë këtë Rregullore.

Bashkangjitur gjeni Rregulloren e Komunës së Vushtrrisë.

Me respekt,


Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm
Ministrisë së Administrimit të Pushtetit
Lokal

Kopje: Lumnije Hetemi-MF
Fetije Begolli-MAPL
Jak Ndreca-MF
Driton Xhafa-MAPL
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Priština, Datum: 16.01.2013
br. 0203-42

Naim Baftiu
Generalni sekretar
Ministarstvo finansija

Predmet: Propratni dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave dana 15.01.2013 je primilo Uredbu o Opštinskim Porezima, Naknadama, Skupštine Opštine Vučitrna sa ciljem procenjivanja zakonitosti.

Prema odluci Vlade br. 2/119 dana 07.04.2010 o formiranju komisije za razmatranje lokalnih akata, Vama kao predsedavajuće Ministarstvo komisije dostavljamo na razmatranje i procenu zakonitosti ovu lokalnu uredbu.

Uz prilog možete naći uredbu opštine Vučitrna.

Sa poštovanjem,

Besnik Osmani,
Generalni sekretar
Ministarstvo administracije lokalne
samouprave

Koija: Lumnije Hetemi-MF
Fetije Begolli-MALS
Jak Ndreca-MF
Driton Xhafa-MALS
Arhivi MALS-a



Kuvendi i Komunës- Vushtrri

HYRËSE-ULAZNA INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministaro Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data _____
Datum 15.01.2013
Date _____

Mjesla organizative	Nr. i Landës	Shtetlca	Vlera
-11-	0203-42		

Dhjetor 2012

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 12 pika "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 41.2, "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë lartësinë e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime administrative të komunës, që u ofrohen personave fizik dhe juridik të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të lëshimit të dokumenteve publike; përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale, sipas kërkesave të palëve apo sipas detyrës zyrtare; ushtrimin e veprimtarisë afariste; shërbime profesionale për pronësinë e automjeteve motorike; përdorimin apo shfrytëzimin e pronës së komunës; tarifave për çështje të planifikimit dhe urbanizmit; të hyrave nga qiradhënia; gjobave nga trafiku dhe gjobave për shkeljet e rregulloreve të komunës.

1.2 Taksa për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste caktohet për secilin lokacion, ku ushtrohet një veprimtari afariste brenda kufijve të komunës, nëse një shoqëri tregtare ushtron veprimtari afariste në më shumë se në një lokacion në komunë.

1.3 Komuna nuk do t'i lejojë asnjë personi ose ndërmarrjeje e cila nuk është e regjistruar në regjistrin e biznesit të Kosovës, që të ushtrojë veprimtarinë afariste brenda komunës, përveç kur personi ose ndërmarrja dëshmon se në bazë të Ligjit për Shoqëri Tregtare ata janë të liruar nga ky regjistrim.

Neni 2

Inkasimi i të hyrave

Inkasimi i të hyrave komunale, sipas kësaj rregulloreje, apo ndonjë urdhërese administrative, udhëzimi administrativ, të nuxjerra nga ndonjë institucion tjetër qendror, tarifë komunale apo gjobë tjetër, do të bëhen në çdo muaj, në gjashtë muaj apo në fund të vitit, varësisht prej natyrës së tyre dhe ato do të deponohen në buxhetin e komunës, përmes buxhetit të Kosovës.

Neni 3

Taksat, tarifat dhe gjobat mbledhen nga çdo subjekt juridik apo fizik, pa e cenuar të drejtën e tij për të ushtruar veprimtari.

Neni 4

Sipas kësaj rregulloreje, drejtoritë përgjegjëse obligohen që të mbajnë evidencë për pagesat në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

II. LARTËSIA E TARIFAVE, NGARKESAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE

Neni 5

Lartësia e tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që iu ofrohen, do të caktohen sipas drejtorive përkatëse.

Neni 6

6.1	Taksat/tarifat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare në Drejtorinë për Administratë
-----	--

N/r	Shërbimet (dokumenti)	Lartësia e taksës €
1.1	Lëshimi i certifikatës të lindjes, martesës, vdekjes dhe statusit martesor	1.00
1.2	Procedura-ceremonia e kurorëzimit	10.00
1.3	Kurorëzimi jashtë orarit të punës	20.00
1.4	Kurorëzimi jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së organit	50.00
1.5	Lëshimi i certifikatës mbi vendbanimin	1.00
1.6	Përpilimi dhe lëshimi i aktvdekjeve	3.00
1.7	Lëshimi i certifikatës që personi është gjallë- në jetë	2.00
1.8	Lëshimi i certifikatës mbi gjendjen familjare	2.00
1.9	Lëshimi i certifikatës mbi shtetësinë	1.00
1.10	Lëshimi i certifikatës mbi identitetin	2.00
1.11	Lëshimi i certifikatës mbi vendqëndrimin	2.00
1.12	Vërtetim që personi i caktuar nuk është banor i Komunës së Vushtrrisë	2.00
1.13	Vërtetim mbi varshmërinë materiale nga personi i caktuar	5.00
1.14	Përpilimi dhe lëshimi i deklaratës së dëshmitarit	1.00
1.15	Vendimi mbi ndërrimin e emrit personal	20.00
1.16	Vendimi mbi korrigjimet e mëvonshme në LAL, LAM dhe LAV	1.00
1.17	Ankesa kundër vendimit të organit të shkallës së parë	Pa pagesë
1.18	Lëshimi i vërtetimit mbi shpenzimet e varrimit	Pa pagesë
1.19	Vërtetim identik me origjinalin (një kopje)	1.00
1.20	Vërtetim për lajmërimin – çlajmërimin e vendbanimit	2.00
1.21	Shërbimet jashtë selisë së organit (sigurimi i transportit-automjetit)	10.00
1.22	Gjetja – sigurimi i dokumenteve në arkivin e drejtorisë	2.00
1.23	Lëshimi i akteve me foto, vetëm për nevoja të brendshme	3.00
1.24	Vërtetime, certifikata të ndryshme të palëve, që nuk janë të përfshira më lart	2.00
1.25	Kërkesa tjera të ndryshme	1.00
1.26	Kërkesë për lirim dhe marrjen e shtetësisë për të rritur	10.00
1.27	Kërkesa për lirim dhe marrjen e shtetësisë për të mitur	5.00
1.28	Lëshimi i vërtetimit mbi kapacitetin martesor	2.00
1.29	Fotokopjimi i dokumenteve për nevojat e qytetarëve, për një faqe	0.20

6.2	Nga taksat për pagesa për shërbimet e kryera nga neni 1.1 deri 1.29, në bazë të paragrafit 6.1 të këtij neni lirohen: a) Familjet e dëshmorëve, shfrytëzuesit e ndihmës sociale, invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes, veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes, familjet e viktimave civile të luftës, të burgosurit politik dhe invalidët civil të luftës. b) Lirimi nga pagesa e taksës komunale, do të bëhet pasi që pala – kërkuesi ta paraqesë dëshminë mbi statusin përkatës. c) Përjashtim për lirim nga tarifat 1.1-1.29 të paragrafit 6.1 bëjnë tarifat: 1.3, 1.4, 1.12, 1.15, 1.21, 1.26, dhe 1.27
6.3	Përveç lirimimit nga neni 6 paragrafi 2, për të gjitha tarifat lirohen kërkesat zyrtare.
6.4	Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Vushtrisë, apo drejtpërsëdrejti te zyrtari i autorizuar, i cili obligohet që palës t'i jep dëshmi mbi pagesën e bërë.

Neni 7

7.1 Tarifat (ngarkesat) për ushtrimin e veprimtarisë afariste

Nr. i tarifës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjjobat	Vlera €
Veprimtaritë afariste		
1.1	Kompanitë publike, industria e përpunimit të metaleve, drurit, ushqimit, ngjyrave dhe industritë tjera prodhuese-përpunuese	800.00
1.2	Prodhuesit e mesëm (të plastikës dhe të drurit)	400.00
1.3	Prodhuesit e pijeve alkoolike	450.00
1.4	Prodhuesit e materialit ndërtimor (bllokave, betonit, gypave nga betoni etj)	160.00
1.5	Prodhuesit e mobilie	240.00
1.6	Gurthyesit	1.000.00
1.7	Përpunuesit e prodhimeve të mishit (therrtoreset)	320.00
1.8	Prodhuesit e elementeve të plastikës, aluminit etj	200.00
1.9	Bankat dhe ekspoziturat	700.00
1.10	Këmbimore	240.00
1.11	Kompanitë e sigurimeve (filialet)	300.00
1.12	Ndërmarrjet tregtare me shumicë -me depo	480.00
1.13	Ndërmarrjet ndërtimore	300.00
1.14	Ndërmarrjet transportuese	200.00
1.15	Depot me material ndërtimor	250.00
1.16	Hotelet	350.00
1.17	Motelet	300.00
1.18	Restorantet	200.00
1.19	Kafiteritë dhe autoshkollat	120.00
1.20	Agjencionet e shpërndarjes dhe autotregjet	200.00
1.21	Vendparkingjet private	100.00

1.22	Agjencitë e sigurimit të automjeteve	240.00
1.23	Agjencitë turistike	160.00
1.24	Agjencitë për transferim të parave	250.00
1.25	Shërbimet bujqësore-veterinare	90.00
1.26	Barnatoret farmaceutike	200.00
1.27	Pompat e benzinës	500.00
1.28	Rrjeti kabllorik me internet	800.00
1.29	Radiot	80.00
1.30	NTP dhe marketet	160.00
1.31	Supermarketet	300.00
1.32	Hipermarket	750.00
1.33	Bodrumet (depot e pijeve)	120.00
1.34	Libraritë	120.00
1.35	Shitoret optike, kozmetike, bizhuteritë, lulishtet, videoklubet, sektorët në shtëpinë e mallrave	90.00
1.36	Mobilshopet	90.00
1.37	Internetet	90.00
1.38	Prerësit e automjeteve të vjetra	300.00
1.39	Bingot	700.00
1.40	Lojërat tjera të ndryshme	90.00
1.41	Mullisët	200.00
1.42	Rikuperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jometalike	120.00
1.43	Mishtoret	200.00
1.44	Qebaporet, gjellëtoreset, burektoret etj.	100.00
1.45	Kafë-gajtoreset	50.00
1.46	Bukëpjekësit, ëmbëltoreset, piceritë, diskobaret	120.00
1.47	Autoservisët, llokerat, autoelektricitët, axhystatorët	100.00
1.48	Autotransportuesit taksit për mallra	80.00
1.49	Ndërmarrjet shërbyese	100.00
1.50	Metalpunuesit	100.00
1.51	Zdrukthëtarët, prodhues të dyerve dhe dritareve, si dhe elementeve tjera	120.00
1.52	Moler-gipserët, shtypshkronjat, prodhuesit e elementeve të betonit	90.00
1.53	Instaluesit e rrymës, ujit	90.00
1.54	Pishinat	100.00
1.55	Fushat sportive	100.00
1.56	Xhamprerësit	80.00
1.57	Kontrollimi teknik i automjeteve	400.00
1.58	Pompat e butangasit	250.00
1.59	Montuesit e bombolave të butangasit	100.00
1.60	Përpunuesit e rrethojave të varrezave nga metali apo mermeri	160.00
1.61	Telefonitë fikse private (çmimi për kabinë)	16.00
1.62	Bastoret sportive	700.00
1.63	Rregullimi (riparimi) i boshpompave, vullkanizerët, riparuesit e aparateve TV	80.00
1.64	Kompanitë e sigurimit fizik të objekteve dhe personave	250.00
1.65	Tregtia me pakicë e aparateve elektrike të përdorura (të	90.00

	importuara)	
1.66	Tregtia me shumicë e aparateve elektrike, të përdorura, të importuara	240.00
1.67	Dhënia me qira e automjeteve (Renta Car)	120.00
1.68	Dhënia me qira e mjeteve të punës	80.00
1.69	Instaluesit e alarmeve	50.00
Veprimtaritë zejtare		35.00
2.1	Orëtarët	160.00
2.2	Argjentarët	100.00
2.3	Sallonet e ondulimit	40.00
2.4	Fotografët	100.00
2.5	Punuesit e gurëve të varrezave	
Veprimtaritë profesionale		80.00
3.1	Ordinancat e mjekësisë familjare	
3.1.1	Ordinancat specialistike stomatologjike	200.00
3.1.2	Ordinancat specialistike kirurgjike	240.00
3.1.3	Ordinancat tjera specialistike	200.00
3.2	Qendrat diagnostike	500.00
3.3	Avokaturat	200.00
3.4	Noteritë	300.00
3.5	Auditorët	96.00
3.6	Rëntgenët privat	200.00
3.7	Laboratorët mjekësor	200.00
3.8	Byrotë projektuese	200.00
3.9	Zyrat që ofrojnë shërbime juridike të kontabilitetit dhe financave	90.00
3.10	Institucionet private të arsimit parafillor	90.00
3.10.1	Institucionet private të arsimit fillor	200.00
3.10.2	Institucionet private të arsimit të mesëm	350.00
3.10.3	Institucionet private të arsimit të lartë	500.00
3.11	Tregtia me pakicë e mjeteve medicinale dhe ortopedike	100.00
3.12	Të tjerët (përfshihen rastet kur mungon tarifa për një veprimtari të caktuar)	100.00
3.13	Bizneset e licencuara, të cilat përveç aktivitetit kryesor zhvillojnë edhe aktivitete tjera, do t'u llogaritet taksa shtesë komunale 50 % të bazës	50%
3.14	Vërtetimi i kontratave mbi shitblerjen	60.00
3.15	Vërtetimi i kontratës mbi qiranë, dhuratën dhe të ngjashme	16.00
3.16	Certifikatë mbi vlerësimin financiar	60.00
3.17	Vërtetimi i kontratës mbi shitblerjen e automjetit të udhëtarëve	16.00
3.18	Vërtetimi i kontratës mbi shitblerjen e automjetit transportues me peshë bartëse deri në 3.t.	16.00
3.19	Vërtetimi i kontratës mbi shitblerjen e automjetit transportues me peshë bartëse mbi në 3.t.	24.00

3.20	Transaksione tjera	8.00
3.21	Transaksione tjera që bëhen në trashëgimi, dhuratat në rendin e parë të trashëgimisë, lirohen nga pagesa	0.00
3.22	Shpuesit e puseve	240.00
3.23	Ekskavatorët	120.00

7.2 Të gjitha SHPK-të do të ngarkohen me taksë në firmë, varësisht nga veprimtaria afariste të cilën e ushtrojnë, duke u bazuar në pikën 1.1 të nenit 7.1 dhe deri te pika 3.23.

7.3 Të gjitha subjektet afariste, të cilat veprojnë në komunën tonë dhe selinë e kanë jashtë territorit të Komunës së Vushtrrisë, do të paguajnë 70% të tarifës bazë.

7.4 Përjashtim nga paragrafi 7.3 i kësaj rregulloreje bëjnë subjektet afariste që merren me shërbime postare, telefonike dhe bankare, sigurimet e pasurive dhe të njerëzve, pompat e benzinës, supermarketet, hipermarketet, bastoret sportive që paguajnë 100 % të tarifës së kësaj rregulloreje.

7.5 Për moskryerjen e obligimit me kohë merren masa ndëshkuese me kamatë ligjore.

7.6 Tarifat dhe ngarkesat prej pikës 1.1 deri 1.69, 2.1 deri 2.5 dhe 3.1 deri 3.23, sipas nenit 7.1 të kësaj rregulloreje paguhen paraprakisht në 2 këste (kësti i parë prej 01 janar deri më 30 qershor, kurse kësti i dytë prej 1 korrikut deri më 31 dhjetor të vitit përkatës.

7.7 Nga tarifrat dhe ngarkesat prej 2.1 deri 3.1 lirohen këto zeje të vjetra: kacagjinjtë, saraçët, brishkagjinjtë, harrnuesit e këpucëve, amargjinjtë, litarpunuesit, përpunuesit nga druri (magjepunuesit, punuesit e kutive për paje të nusërisë), punuesit e shoshave, enëve, veglave muzikore dhe përpunuesit tradicional të leshit: qeleshepunuesit, xhemperpunuesit, zhgunapunuesit, qilimpunuesit, çorappunuesit, përpunuesit e argjilës dhe filigranit, kallajgjinjtë, farkëtarët dhe mbathtarët.

7.8 Subjektet afariste pasive në komunë, lirohen nga pagesa e taksës komunale dhe bëhet revidimi i vendimit paraprak, për bizneset që e kanë mbyllur veprimtarinë e tyre për shkak të afarizmit negativ apo ato që kanë pasur fatkeqësi natyrore, kurse të drejtën nga ky paragraf e kanë bizneset të paraqesin dëshmi si: certifikatë mbi shuarjen e biznesit nga QKB-ja, raportin e qarkullimit të biznesit nga ATK-ja, procesverbalin nga KEK-u, raportin nga zjarrfikësit, raportin nga Policia e Kosovës, dhe procesverbalin nga zyrtarët kompetent të DBF-së (zyrtarët e terrenit).

7.9 Subjektet afariste me seli jashtë Komunës së Vushtrrisë, të cilat kryejnë punë në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në lëminë e ndërtimtarisë së lartë, si: ndërtimi i banesave kolektive, objekteve industriale, komerciale, arsimore e të ngjashme, (përveç atyre për banim individual me infrastrukturë përcjellëse), instalime ajrore, në lëminë e energjetikës, telekomunikacionit dhe të ulët (punët e instalimit nëntokësor të rrymës, ujit, kanalizimit, telekomunikacionit, asfaltimit të rrugëve dhe terreneve të ndryshme, e të ngjashme).....600.00 €.

7.10 Lirohen nga pagesa e taksës në firmë të gjitha bizneset me karakter prodhues-bujqësor, si vijon: fermat e shtazëve, shpezëve, bletëve, qumështoret, të gjithë

prodhuesit e drithërave dhe perimeve, kultivuesit dhe rritësit e peshqve; mbledhësit dhe grumbulluesit e frutave pyjore dhe përpunuesit e pemëve dhe perimeve.

7.11 Lirohen nga pagesa e taksës komunale të gjitha bizneset e regjistruara në vitin e parë të afarizmit, kurse nga ky lirim përjashtohen këto biznese: lojërat e fatit (bastoret sportive), bankat, postat telefonike, pompat e naftë dhe derivateve të naftës, institucionet financiare që merren me transferet e parasë, kompanitë e sigurimeve të personave fizik dhe automjeteve, kompanitë e rrjetit mobil, televiziv dhe internet.

7.12 Ndërsa nuk lirohen nga pagesa e taksës komunale bizneset që vazhdojnë veprimtarinë e njëjtë, por ndërtojnë pronarin apo emrin e biznesit.

Neni 8

TARIFAT E SHËRBIMEVE PUBLIKE

1. Tarifa vjetore për parkingje pronë komunale, para ndërtesave dhe objekteve tjera janë:		
1.1	Kamionët, autobusët	80.00
1.2	Vetura, parkimi me veprimtari profitabile (biznes)	80.00
1.3	Kombibusët, tarifa vjetore	48.00
1.4	Veturat	40.00
1.5	Ndalja e veturave për ngarkim-shkarkim, ku ka hapësirë të mjaftueshme	40.00
1.6	Veturat taksit	24.00
2. Shfrytëzimi i trotuareve për ndërtime dhe renovime të ndryshme, kompensimi ditor		
2.1	Zona e I	0.30€/m
2.2	Zona e II	0.20€/m
2.3	Zona e III	0.10€/m
3. Pagesa vjetore për regjistrim të automjeteve		
3.1	Për automjetet që peshojnë deri në 3.5 t	10.00
3.2	Për automjetet që peshojnë mbi 3.5 t.	20.00
4. Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese - tarifa vjetore për m ²		
4.1	Zona urbane	30.00
4.2	Zona jashtë urbane	20.00
4.3	Pllakatet (panot) reklamuese me ndriçim, paguhen me tarifë të shtuar	30 %
4.4	Vendosja e reklamave elektronike - ekraneve, tarifa vjetore për m ²	150.00
4.5	Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike-ekspozimi (reklamimi) për 1 m ² , tarifa mujore	10.00
4.6	Vendosja e foltoreve telefonike	120.00
5. Shërbime tjera		
5.1	Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike në bazë të kërkesave të qytetarëve, për vendosjen e pengesave në rrugë	25.00
5.2	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për	25.00

	24 orë	
5.3	Leje për bllokim të rrugës – shiritit rrugor – trotuarit për 24 orë	25.00
5.4	Vërtetimi i rendit të udhëtimit - Operatori transportues paguan taksën për një vit për 1km.	0.50
5.5	Leje për hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 t, për 24 orë	25.00
5.6	Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për vendparkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtarë	30.00
5.7	Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore	10.00
5.8	Leja për shfrytëzime tjera të hapësirës publike, ekspozimi-reklamimi ditor në tavolina, tenda të ndryshme për 1 m ² - tarifa ditore	2.00
6. Parkingu kohor për 1 orë		
6.1	Në parkingjet e KK-së	0.50
6.2	Në parkingjet publike në shirit të ndara të rrugëve – zona I	0.50
6.3	Në parkingjet publike në shirit të ndara të rrugëve – zona II	0.20

- Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak se 30 ditë shtohet vlera për 100 %, kurse nëse pllakata është shumëkrahëshe, paguhet për çdo krah të dukshëm.
- Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar.
- Nga pagesa për leje për mjete motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (ambulanca dhe makinat e zjarrfikësve).

Neni 9

Tarifat në sferën e urbanizmit

KOMPENSIMI PËR RREGULLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NDËRTIMORE

- 9.1 Zona e I-rë përfshin 17 planet rregulluese të parapara me PZHU, në sipërfaqe prej 751 ha;
- 9.2 Zona e II-të përfshin të dy anët e magjistrales nga fsh. Smrekonicë deri në fsh. Gracë, në distancë prej 150 m nga magjistralla;
- 9.3 Zona e III-të përfshin të gjithë fshatrat e Komunës së Vushtrisë, përveç fshatrave që janë të përfshira në zonë e IV-të;
- 9.4 Zona e IV-të përfshin këto fshatra: Vesekoc, Kurillovë, Kunovik, Bozhlan, Gumnishtë, Shilovicë, Skromë, Skoqne, Zagorë, Liqej, Galicë, Duboc dhe Beçiq;
- 9.5 Lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore bazohet dhe llogaritet për m², të sipërfaqes neto shfrytëzuese për ndërtim;
- 9.6 Kryefamiljarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-ës, lirohen nga pagesa e taksës komunale, për marrjen e lejes ndërtimore për ndërtim të objektit banesor individual.

Neni 10

Ndërtimi i objekteve me destinim për banim (deri 450m²)

- Zona e parë.....4.00 €/m²;
- Zona e dytë..... 3.00 €/m²;
- Zona e tretë..... 2.00 €/m²;
- Zona e katërt.....1.00 €/m².

Neni 11

Ndërtimi i objekteve me destinim për banim (mbi 450m²)

- Taksa për të gjitha zonat 6.00 €/m².

Neni 12

Ndërtimi i objekteve investive me destinim afarizëm

- Zona e parë.....8.00 €/m²;
- Zona e dytë.....6.00 €/m²;
- Zona e tretë4.00 €/m²;
- Zona e katërt..... 2.00 €/m².

Neni 13

Ndërtimi i objekteve industriale

- Zona e parë..... nuk lejohet;
- Zona e dytë..... nuk lejohet;
- Zona e tretë..... 8.00 €/m²;
- Zona e katërt.....4.00 €/m².

Neni 14

Për shndërrimin e objekteve banesore në objekte afariste

- Zona e parë.....7.00€/m²;
- Zona e dytë..... 5.00 €/m²;
- Zona e tretë.....3.00 €/m²;
- Zona e katërt..... 2.00 €/m².

Neni 15

Për ndërtimin e bodrumeve në kuadër të banesave

- Zona e parë.....2,00 €/m²;
- Zona e dytë.....1.50 €/m²;
- Zona e tretë..... 1,00 €/m²;
- Zona e katërt..... 0,50 €/m².

Neni 16

Për ndërtimin e depove të ndryshme-angareve

- Zona e parë4.00 €/m²;
- Zona e dytë..... 3.00 €/m²;
- Zona e tretë..... 2.00€/m²;
- Zona e katërt.....1.00€/m².

Neni 17
Për ndërtimin e garazheve

• Zona e parë.....	1,50 €/m ² ;
• Zona e dytë.....	1.00€ /m ² ;
• Zona e tretë.....	0,50€/m ² ;
• Zona e katërt.....	0,25€/m ² .

Neni 18
Për ndërtimin e objekteve si: tregje, pishina, parkingje, pllato, fusha sportive,
palestra sportive dhe të ngjashme

• Zona e parë.....	4.00 €/m ² ;
• Zona e dytë.....	3.00 €/m ² ;
• Zona e tretë.....	2.00 €/m ² ;
• Zona e katërt.....	1.00 €/m ² .

Neni 19
Për ndërtimin e objekteve për depozitim të mbeturinave të ngurta

• Zona e parë.....	nuk lejohet;
• Zona e dytë.....	nuk lejohet;
• Zona e tretë.....	1.00 €/m ² ;
• Zona e katërt.....	0.50 €/m ² .

Neni 20
20.1 Kompensimi për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore,
në pronësi të komunës për m² në muaj:

• Zona e parë.....	2.00 €/m ² ;
• Zona e dytë.....	1,00 €/m ² ;
• Zona e tretë.....	0.50 €/m ² ;
• Zona e katërt.....	0.25 €/m ² .

20.2 Dhënia e pronës së komunës në shfrytëzim, për zhvillim ekonomik- lokal:

- a) Çmimi i qirasë mujore për zonën përgjatë magjistrales, për 1 ari është 0.25 €, ndërsa për objektet në këtë zonë për 1m² është 0.10 €;
- b) Çmimi i qirasë mujore për zonën që përfshin periferinë e magjistrales, në distancë prej 200 e më tepër metra nga rruga magjistrale, për 1 ari është 0.20 €;
- c) Çmimi i qirasë mujore për zonat kodrinore-malore, për 1 ari është 0.10 €.

20.3 Në rastin e konkurrimit për marrje në shfrytëzim të pronës komunale në kushte të barabarta, përparësi do të kenë kompanitë e regjistruara në Komunën e Vushtrisë.

Neni 21

Kompensimi për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike para lokaleve afariste
(kompensimi mujor për m²)

• Zona e parë	1.50 €;
• Zona e dytë.....	1.20 €;
• Zona e tretë.....	1.00 €;
• Zona e katërt.....	0.25 €.

Neni 22

Kompensimi për vendosjen e autodromeve, cirqeve, parqeve zbavitëse për fëmijë dhe poligoneve për aftësimin e vozitësve me mjete motorike, kompensimi mujor për m²:

• Zona e parë	4.00 €;
• Zona e dytë.....	3.00 €;
• Zona e tretë.....	2.00 €;
• Zona e katërt.....	1.00 €.

Neni 23

23.1 Për katin e tretë e tutje, tarifa për rregullimin e tokës ndërtimore zbritet për 15%, kurse aty ku lejojnë kushtet teknike për mbindërtime , vlejnë të njëjtat kushte.
23.2 Për peizazhe në objekte ndërtimore nuk llogaritet taksa.

Neni 24

Ånëksndërtimet dhe mbindërtimet në objektin ndërtimor ekzistues, i cili është i ndërtuar me leje në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen ndërtim i ri, andaj kompensimi caktohet sipas shkallëve dhe kriterëve të parapara për llojin përkatës të ndërtimeve.

Neni 25

25.1 Identifikimi i parcelës në terren dhe dhënia e protokollit.....	15.00 €;
25.2 Caktimi i kushteve urbanistike-leja urbanistike.....	15.00 €;
25.3 Tarifa për vendosjen e transmetuesve, antenave me frekuenca të ndryshme për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit dhe tjera të ngjashme, paguhet tarifa paushall prej.....	300.00 €;
25.4 Taksë vjetore për transmetues, antena me frekuenca të ndryshme dhe objekte tjera të ngjashme, për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit paguhet taksa vjetore në zonën urbane prej.....	500.00 €; ndërsa në zonën rurale 300.00 €;
25.5 Për shtrirjen e rrjetit të përçuesve nëntokësor dhe mbitokësor kabllovik (elektroenergjetik dhe telekomunikacionit optik), çmimi kalkulohet për metër gjatësi:	
25.5.1 Shtrirja e rrjetit kabllor (ajror) të internetit, për metër gjatësi.....	0.60 €;
25.5.2 Vendosja e ormanëve shpërndarëse MDF, për copë, tarifë mujore.....	10.00 €;
25.5.3 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore (vendosja e rrjetit kabllovik – internet) për metër gjatësi	2.00 €.

Neni 26

26.1 Taksa për marrjen e lejes për ndërhyrjet në infrastrukturën dhe hapësirat tjera publike:

- 26.1.1 Leja për prerjen e asfaltit në rrugë për metër katror50.00 €;
- 26.1.2 Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të paasfaltuara, parqeve, kubëzave të betonit, etj për metër katror25.00€;
- 26.1.3 Taksa për marrjen e lejes për vendosjen e objekteve të tjera të vogla (pajisje të caktuara teknike bankomat) për metër katror.....10.00€;
- 26.1.4 Tarifa për rregullimin e tokës ndërtimore për lokalitetet që nuk përfshihen në regionin e gjerë të planit urbanistik, për këto raste do të aplikohet tarifa përkatëse sipas zonës dhe llojit të objektit, e zbritur për 50%.

Neni 27

Përfshirje nga obligimi për pagesën për kompensim të rregullimit të tokës ndërtimore bëjnë:

- Objektet për të cilat investues janë: institucionet shtetërore të Kosovës dhe institucionet komunale;
- Objektet e karakterit të përgjithshëm shtetëror dhe publik;
- Objektet e infrastrukturës teknike komunale;
- Objektet e mbrojtjes shëndetësore, sociale, arsimit, shkencës, kulturës, artit, rekreacionit dhe sportit;
- Objektet e ndërtuara me donacione;
- Personat-investuesit, të cilët bëjnë adaptimin dhe renovimin e brendshëm, gëllqerorshen-ngjyrosjen e jashtme dhe përfundimin-ndërrimin e tregullave të çatisë, në kuadër të gabaritit dhe etazhitetit të objektit ekzistues, të ndërtuar legalisht dhe pa ndërrim të destinimit;
- Personat, të cilët janë të pajisur paraprakisht me leje ndërtimi për hapësirën, për të cilën posedon dëshmi (dokumente) se ka qenë i pajisur me leje dhe
- Objektet fetare, nëse objektet e tilla nuk shërbejnë për afarizëm dhe përfitim.

Neni 28

28.1 Të gjithë personat fizik apo juridik, kompensimin e tokës ndërtimore e bëjnë përpara marrjes së lejes ndërtimore, po që se nuk është rregulluar ndryshe me ndonjë akt të veçantë.

28.2 Mjetet e inkasuara nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore, nuk mund të përdoren për qëllime tjera përveç për rregullimin e tokës ndërtimore në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 29

Objektet e përkohshme

29.1 Për ndërtimin-vendosjen e objekteve montuese afariste

- Zona e parë.....6.00 €/m²;
- Zona e dytë.....5.00 €/m²;
- Zona e tretë..... 3.00 €/m²;
- Zona e katërt.....1.00 €/m².

29.2 Për ndërtimin e objekteve të përkohshme afariste me material të fortë

- Zona e parë.....8.00 €/m²;
- Zona e dytë.....6.00 €/m²;
- Zona e tretë.....4.00 €/m²;
- Zona e katërt.....1.00 €/m².

29.3 Për ndërtimin e objekteve të përkohshme (garazhe, rrethoja, lokale ndihmëse)

- Zona e parë.....2.00 €/m²;
- Zona e dytë.....1.00 €/m²;
- Zona e tretë.....0.50 €/m²;
- Zona e katërt.....0.25 €/m².

29.4 Për lëshimin e certifikatave për pëlqim sanitar, si dhe aktvendimet mbi pranimin teknik të lokaleve afariste lidhur me plotësimin e kushteve teknike, caktohen tarifat si vijon:

- Për lokale afariste deri në 30 m² 10.00 €;
- Për lokale afariste deri në 50 m² 20.00 €;
- Për lokale afariste mbi 100 m² 50.00 €;
- Për objekt banimi deri 200 m² 20.00 €;
- Për objekt banimi mbi 200 m² 40.00 €.

Neni 30

Tarifa për leje mjedisore komunale, si pjesë përbërëse e dokumentacionit të domosdoshëm për leje ndërtimore, tarifa paushalle15.00 €.

Neni 31

Tarifat e sferës së shëndetësisë

31.1 Taksat në sferën e kujdesit parësor shëndetësor:

N/r	Shërbimet/aktivitetet	Lartësia e taksës €
Shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH)		
1.1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
1.2.	Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF me udhëzim të mjekut familjar	2.00
1.3.	Ekzaminimi specialistik në QMF QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4.00
1.4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00
1.5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike (për recetë)	0.30
1.6.	Ultrazëri standart	2.00
1.7	Radiografia	2.00
1.8	EKG	0.50

1.9	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
1.10	Analizat laboratorike (komplet)	3.00
1.11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
1.12	Audiogrami	1.00
1.13	Shpërlarja e veshit	1.00
1.14	Dhënia e ineksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
1.15	Dhënia e ineksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
1.16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
1.17	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
1.18	Certifikata e vizitës e lëshuar nga konsiliumi profesionist	18.00
1.19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00
1.20	Dhënia e raportit mjekësor – vërtetimit ose dokumentit tjetër, në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
Shërbimet stomatologjike në nivelin e QMF-së		Lartësia e taksës €
1.21	Vizita e parë stomatologjike	1.00
1.22	Rtg i dhëmbit	1.50
1.23	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00
1.24	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00
1.25	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	5.00
1.26	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.27	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.28	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.29	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.30	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.31	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00
1.32	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
1.33	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
1.34	Vulosja e fisurave	1.00
1.35	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
1.36	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
1.37	Kiretazha e gjepave parodontal (një dhëmbë)	1.00
1.38	Nxjerrja e dhëmbit	1.00
1.39	Incizioni intra dhe extra oral	1.50
1.40	Heqja e kursorës me anë të prerjes	1.00

1.41	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50
Shërbimet stomatologjike të nivelit dytësor – QKMF-së (në qendrat regjionale)		
1.42	Vizita e parë stomatologjike	1.50
1.43	RTG i dhëmbit	1.50
1.44	RTG ortopantomogrami	3.00
1.45	Mbushje e përhershme (me amalgamë)	4.00
1.46	Mbushje e përhershme (me kompozitë)	5.00
1.47	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
1.48	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
1.49	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
1.50	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme me amalgamë apo kompozitë)	6.00
1.51	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
1.52	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
1.53	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	8.00
1.54	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
1.55	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
1.56	Vulosja e fisurave	1.00
1.57	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
1.58	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	4.00
1.59	Kiretazha e gjerpave paradontal (një dhëmbë)	1.00
1.60	Ndërhyrjet operative paradontale	12.00
1.61	Elektroforeza e barërave (1 seancë)	1.50
1.62	Splintet (fiksimi i dhëmbëve)	7.00
1.63	Dekortikimi selektiv i dhëmbit	1.00
1.64	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
1.65	Nxjerrja e dhëmbit në mënyrë operative	4.00
1.66	Nivelizimi i zgjatimit alveolar	6.00
1.67	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50
1.68	Apikotomia	12.00
1.69	Plastika e sinusit	12.00
1.70	Frenektomia	2.00
1.71	Trajtimet kirurgjiko-paraprotetikore (ndërhyrja lokale operative në indet e forta dhe të buta)	8.00
1.72	Ekzaminimi mjekësor (stomatologjik) në ambulancën specialistike të kirurgjisë maksillofaciale me udhëzim të mjekut nga institucioni regjional)	2.00
1.73	Ekzaminimi mjekësor (stomatologjik) në ambulancën specialistike të kirurgjisë maksillofaciale pa udhëzim të mjekut nga institucioni regjional)	6.00
1.74	Kurora ose anëtari prej metal-qeramike	20.00
1.75	Rindërtimi i derdhur apo i gatshëm	3.00
1.76	Reparatura e kurorave dhe urave	3.00

1.77	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.50
1.78	Proteza parciale apo totale prej rezinës	20.00
1.79	Riparimi i protezës (ngjitja)	2.00
1.80	Zëvendësimi i dhëmbit të humbur në protezë (deri në 3 dhëmbë)	3.00
1.81	Ribazimi direkt apo indirekt i protezës	3.00
1.82	Protezë e skeletuar metalike (komplet me dhëmbë)	35.00
1.83	Aparati ortodontik aktiv	25.00
1.84	Aparati ortodontik funksional	35.00
1.85	Riparimi i aparatit ortodontik	3.00
1.86	Ruajtësi i hapësirës	6.00
Tarifat në sferën e kujdesit shëndetësor publik		
1.87	Pëlqimi sanitar	10.00
1.88	Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit prej 5 deri në 100 kg dhe lëshimi i vërtetimit	50.00
1.89	Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit mbi 100 kg dhe lëshimi i vërtetimit	100.00
1.90	Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit dhe lëshimi i vërtetimit (sipas kërkesës së palës)	15.00
31.2	Nga bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të ofruara, sipas paragrafit 7.1 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e popullatës të parapara me nenin 22 të ligjit për shëndetësi nr. 4/2004.	
31.3	Çmimet për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas paragrafit 7.1 për shtetasit e huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja, do të jenë për pesë (5) herë më të larta se sa për banorët e Kosovës.	

31.4 Tarifat në sferën e shëndetësisë dhe çështje sociale, janë të caktuara dhe do të paguhen në bazë të Udhëzimeve Administrative, të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës.

31.5 Përjashtohen nga bashkëpagesa, shërbimet shëndetësore dhe grupet e veçanta të popullatës, në përputhje me:

- Ligjin për Shëndetësi, Nr. 4/2004, neni 22;
- Ligjin për Kujdesin Shëndetësor Emergjent Nr. 02/L-50 neni 13;
- Ligjin mbi Familjen, Nr. 32/2004, neni 5 paragrafi 1 dhe neni 7 paragrafi 1;
- Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-ës, si dhe familjeve të viktimave civile të luftës;
- Përjashtohen nga bashkëpagesa edhe format e përcaktuara me nenin 22.2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 4/2004.

Neni 32

Lartësia e tarifës vjetore komunale

- Tarifa vjetore për tregun e bagëtive në Bukosh.....160.00 €;
- Tarifa vjetore për tregun e gjelbër në Vushtri.....300.00€;

32.3 Tarifat në sferën e bujqësisë dhe pylltarisë janë të caktuara në Ligjin mbi tokat bujqësore dhe do të llogariten në bazë të këtij ligji, për shkak të transparencës dhe informimit të qytetarëve duhen të jenë pjesë përbërëse e rregullores

Neni 33

Tarifa në sferën e arsimit

33.1 Tarifa për provime private në arsim, është e caktuar dhe do të paguhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kosovës.

33.2 Pagesa për parashkollorët në çerdhen "Foleja" në Vushtri për një muaj është me sa vijon:

33.2.1 Për një fëmijë - 30.00 €;

33.2.2 Për dy fëmijë - 51.00 €;

33.2.3 Për tre fëmijë - 66.00 €;

33.2.4 Për fëmijën e katërt-gratis.

Neni 34

Tarifa në sferën e kulturës

Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina":

- a) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme pa zërim, pa dekor 30.00€, paushall 60.00€;
 - b) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme me zërim, dekor 50.00€, paushall 160.00€ (materiali për dekor i organizatorit);
 - c) Për shfaqjen e koncerteve dhe shfaqjeve teatrale, organizatori duhet të paguajë 30% nga numri i biletave të shitura në këto raste. Çmimin e biletës e cakton organizatori, kurse Qendra për Kulturë obligohet të sigurojë kushtet e nevojshme: sallën, zërimin ngrohjen, shitjen e biletave, CD plajerin;
 - d) Nëse organizatori zgjedh formën paushall pagesa do të kushtojë 50.00€ dhe pagesën duhet ta bëjë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës;
 - e) Shfrytëzuesi i sallës dhe shërbimeve tjera është i obliguar që të bëjë caktimin e terminit 48 orë para fillimit të shfaqjes apo programeve të ndryshme;
 - f) Lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirës-salla e madhe e QK "Hasan Prishtina", si vijon:
- Tubimet e organizuara nga komuna, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (Dega në Vushtri), shoqata "HANDIKOS", organizatat rinore dhe të ngjashme, të cilat nuk kanë karakter përfitues.

Neni 35

Tarifa në sferën e sportit

35.1 Pagesat për shfrytëzim të Palestrës së Sporteve janë si vijon:

- a) Për 90 min. stërvitje për shkollat sportive (private)
 - me ndriçim 6.00 €;
 - pa ndriçim 3.00 €;
- b) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive (meshkujt)
 - me ndriçim 12.00 €;
 - pa ndriçim 10.00 €;

- c) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive (femrat)
 - me ndriçim.....10.00 €;
 - pa ndriçim.....8.00 €;
- d) Ndeshjet sportive me bileta deri në 400 shikues:
 - meshkujt.....50.00 €;
 - femrat.....40.00 €.

35.2 Nga pagesat e përmendura në nenin 36.1 të rregullores në fjalë, lirohen nga pagesa të gjitha klubet sportive të komunës dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, dega në Vushtrri, si dhe televizionet për incizimin e ngjarjeve sportive.

35.3 Ndeshjet sportive me bileta (mbi 400 shikues), 20 % nga shitja e biletave:

- a) për 60 min. për rekreacion për aktivitete të lira:
 - me ndriçim.....12.00 €;
 - pa ndriçim.....10.00 €;
- b) Për shfrytëzimin e palestrës për turnir, për një orë 5 € (gjysmëfinalja dhe finalja plus 30% nga shitja e biletave);
- c) Për shfrytëzimin e palestrës për ngjarje kulturore për një orë-50.00€;
- d) Ngjarjet kulturore ku ka shitje biletash mbi 500 bileta, 30% nga shitja e biletave;
- e) Turniret, kampionatet kombëtare e ndërkombëtare në marrëveshje me organizuesin 30% nga shitja e biletave;
- f) Për shfrytëzimin e terreneve tjera sportive, për një ndeshje kampionate apo për kupë.....250 €;
- g) FSK, dy termine në javë, nga një orë pa pagesë, po ashtu edhe personat me aftësi të kufizuara, dy termine, nga një orë pa pagesë.
- h) Nga pagesat e përmendura të nenit 32 të kësaj rregulloreje, lirohen: shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (të Komunës së Vushtrrisë), për dy termine brenda javës: shoqata "HANDIKOS" për një termin brenda javës.

Neni 36

36.1 Salla e sporteve luftarake

- a) Për 90 min- stërvitja për klubet sportive publike:
 - me ndriçim.....6.00 €;
 - pa ndriçim.....3.00 €;
- b) Për 90 min- stërvitja për klubet sportive private:
 - me ndriçim.....8.00 €;
 - pa ndriçim.....4.00 €;
- c) Për një orë rekreacion:
 - me ndriçim.....4.00 €;
 - pa ndriçim.....2.00 €.

36.2 Salla e pingpongut:

- a) Për 90 min.- stërvitja për klubet sportive publike:
 - me ndriçim.....4.00 €;
 - pa ndriçim.....2.00 €;
- b) Për 90 min.- stërvitja për klubet sportive private:
 - me ndriçim.....8.00 €;
 - pa ndriçim.....4.00 €;
- c) Për 60 min. rekreacion:
 - me ndriçim.....8.00 €;

- pa ndriçim.....4.00 €.

36.3 Për shfrytëzim të Palestrës së Sporteve, lirohen nga pagesa klubet sportive të komunës, që garojnë në ligen e parë dhe Superligën e Kosovës.

Neni 37

Subjekteve të interesuara ju mundësohet vendosja e reklamave të tyre sipas tarifave

37.1 Vendosja e reklamave me dimensione për një muaj:

- a) Në qendrën e fushës së basketbollit, në parket.....40.00 €;
- b) Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit..... 20.00 €;
- c) Në hapësirën e 6 metërshit të fushës së hendbollit -//2 X 0.60 m.....20.00 €;
- d) Në hapësirën brenda f.së basketbollit dhe hendbollit-//2 X 0.60m...20.00 €;
- e) Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit-//3 X 0.60m....20.00 €;
- f) Në pjesën anësore (lindje dhe perëndim) të pallatit 2 X 0,80m.....20.00 €;
- g) Në pjesët tjera të palestrës dimensionit 2 X 0.60m.....10.00 €.

Neni 38

38.1 Nga pagesa për shërbimet e kryera: për Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (iletë poseduese), kopje të planit, kurse për certifikata dhe vërtetime lirohen:

- a) Familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së, invalidët e luftës së UÇK-së, veteranët e luftës së UÇK-së, si dhe familjet dhe individët përfitues të ndihmave sociale;
- b) Lirimi nga pagesa e taksës komunale, nga pika "a" do të bëhet pasi që palakërkuesi ta prezentojë dëshminë mbi statusin përkatës.

38.2 Tarifat për ofrimin e shërbimeve në sferën e gjeodezisë, kadastrit dhe pronës, janë të përcaktuara dhe do të llogariten - paguhën në bazë të; Udhëzimit Administrativ Nr.06/2008 - MSHP dt. 18.08.2008 për tarifën e shërbimeve dhe produkteve kadastrale, të ofruara nga zyrtarët kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodetike të licencuara, si dhe të Udhëzimit Administrativ nr. 2006/01, të Agjencionit Kadastral të Kosovës, për përcaktimin e nivelit të pagesave, për shërbimet e bëra për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme dt. 03.04.2006.

Neni 39

Tarifat në sferën e inspeksionit

39.1 Tarifa për pranime të lokaleve lidhur me kushtet teknike

Parashtruesi i kërkesës - subjekti ekonomik është i obliguar që pas konstatimit mbi plotësimin e kushteve minimale për lokalit afarist, në emër të shpenzimeve të procedurës inspektuese, të paguajë shumën e caktuar në të holla, sipas hapësirës së objektit dhe atë:

Tarifat për pranim teknik të lokaleve afariste		
1.	Për lokalet afariste deri në 20 m ²	10.00 €
2.	Për lokalet afariste prej 21 m ² deri në 50 m ²	20.00 €
3.	Për lokalet afariste prej 51 m ² deri në 100 m ²	40.00 €

4.	Për lokalet afariste 101 m ² deri në 300 m ²	50.00€
5.	Për lokalet afariste 301 m ² deri në 500 m ²	100.00€
6.	Për lokalet afariste 501 m ² deri në 1000 m ²	150.00€
7.	Për lokalet afariste mbi 1000 m ²	200.00€

39.2 PËLQIMET SANITARE

Tarifa për certifikatë, për pëlqime sanitare		
1.	Për lokalet afariste deri në 30 m ²	10.00 €
2.	Për lokalet afariste prej 31 m ² deri në 50 m ²	20.00 €
3.	Për lokalet afariste prej 51 m ² deri në 100 m ²	40.00 €
4.	Për lokalet afariste mbi 100 m ² , për m ²	0.20 €
5.	Për objekte banimi deri në 100 m ²	20.00 €
6.	Për objekte banimi prej 101 m ² deri në 200 m ²	40.00 €
7.	Për objekte banimi mbi 200 m ² , për m ²	40.00 €
8.	Për objekte banimi mbi 200 m ² , për m ²	0.10 €

39.3 Tarifa për mallrat me afat të skaduar apo mallrat e dëmtuara, për asgjësim të tyre

Të gjitha subjektet afariste do të paguajnë tarifën dhe atë:

1.	Malli në peshë prej - 10,00 kg deri në 20,00 kg	10.00 €
2.	Malli në peshë mbi 20,00 kg deri 99,99 kg	30.00 €
3.	Në peshë prej - 100,00 kg deri 999,999 kg	70.00 €
4.	Në peshë prej - 1000 kg deri 10000 kg	150.00 €
5.	Mbi 10000 kg	300.00 €

39.4 Operatorët që veprojnë me transportuesit e udhëtarëve: auto-taxi, operatorët taxi, kombibusët, autobusët, për pranim të kushteve teknike për çdo automjet të tyre do të paguajnë tarifat:

1. Transportuesit e udhëtarëve – me autobus -- ---- 20,00 €;
2. Operatorët – taxi ----- 5,00 €;
3. Auto – taxi ----- 5,00 €;
4. Kombibusët----- 10,00 €.

Neni 40

Gjobat për shkeljen e rregulloreve lokale

40.1 Rregulloret komunale, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Vushtrisë, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave.

40.2 Lartësitë e gjobave janë të bazuara në disproporcion me shkeljet e dispozitave, të rregulloreve komunale.

40.3 Të gjitha subjektet, të cilat nuk i përgjigjen pagesës së tarifave dhe ngarkesave komunale të parapara me këtë rregullore, do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm nëpërmes gjykatës kompetente.

Neni 41

Procedura e Ankesave

41.1 Afati kohor për ankimin administrativ është 30 ditë, nga dita e pranimi të aktit administrativ;

41.2 Kur ankimi administrativ bëhet në formën e kërkesës për rishqyrtim, ai dorëzohet tek organi që e ka nxjerr aktin administrativ, të kontestuar nga palët;

41.3 Kur ankimi administrativ bëhet në formë të ankesës, ai dorëzohet tek organi më i lartë kompetent.

Neni 42

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

42.1 Rregullorja zbatohet nën autoritetin e plotë të komunës dhe nën mbikëqyrjen e drejtorive kompetente.

42.2 Për të gjitha tarifën, ngarkesat dhe gjobat e caktuara, që nuk janë të parapara me këtë rregullore, do të aplikohen tarifën, ngarkesat dhe gjobat e caktuara me ligj dhe udhëzime përkatëse.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Neni 44

Me aprovimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (01. Nr. 742/08, e datës 30.12.2008) mbi Tarifën, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, si dhe të gjitha vendimet për ndryshime dhe plotësime të rregullores në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit

